



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.11.2020, mori këtë

V E N D I M
SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE DIREKTE PËR KOMUNITETE TË
MARGJINALIZUARA

- I. **MIRATOHET** Vendimi për subvencionimin e shërbimeve direkte për komunitete të marginalizuara.
- II. Organizatat që do subvencionohen, sipas shumës:
- Qendra për Shëndet Global në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Filozofisë, Departamenti i Psikologjisë - 24,000.00 Euro;
 - Sindrom Down Kosova - 16,000.00 Euro;
 - Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë - 10,000.00 Euro;
 - Autizmi Flet - 10,000.00 Euro;
 - Handikos - 8,000.00 Euro;
 - Handikos Prishtina - 5,000.00 Euro;
 - Handicap Kosova - 4,000.00 Euro;
 - Shoqata e të Shurdhërve në Prishtinë - 5,000.00 Euro;
 - Klub House Dëshira - 6,000.00 Euro;
 - Nëna dhe Fëmijë të Lumtur - 4,000.00 Euro;
 - Komiteti i Grave të Verbra - 3,000.00 Euro;
 - Labirint - 4,000.00 Euro;
 - OPFAKOS - 2,000.00 Euro;
 - OFAP - 3,000.00 Euro;
 - Instituti Kosovar për Logopedi - 2,000.00 Euro;
 - Voice of Roma, Ashkali and Egyptians - 10,000.00 Euro;
 - CEL - 5,000.00 Euro;
 - CSDG - 5,000.00 Euro;
 - Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve - 11,800.00 Euro;
 - Strehimorja Shpresa dhe shtëpitë e fëmijëve - 10,000.00 Euro;
 - Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore - 8,000.00 Euro.

- III. Të gjitha organizatat që do të përfitojnë këto subvencione janë të obliguara ta asistojnë Qendrën për Punë Sociale në Prishtinë, kurdo që atyre u nevojitet ndihma.
- IV. Të gjitha organizatat që do të përfitojnë këtë subvencion janë të obliguara të përpilojnë një raport për Kuvendin e Komunës, për punën e realizuar, jo më larg se një vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Mirëqenies Sociale.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-452/01-0209859/20, më 12.11.2020

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



A R S Y E T I M

I Vendimit për subvencionimin e shërbimeve direkte për komunitete të marginalizuara

Për shkak të kufizimit të dhënies së subvencioneve në shumën maksimale prej 4,000.00 Euro, sipas Rregullores së MF-së, nr. 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtoria e Mirëqenies Sociale në mënyrë që t'i arrijë objektivat e saj, ka qenë e obliguar që shpërndarjen e subvencioneve ta realizojë përmes mbështetjes së Kuvendit të Komunës. Përfshirë subvencionimit të projektit të studimit të varfërisë, që do të realizohet nga Departamenti i Psikologjisë, i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, të gjitha organizatat tjera që kanë pranuar subvencione vitin e kaluar për të ofruar shërbime direkte, janë përfshirë edhe gjatë këtij viti, si dhe mjetet e propozuara janë dakorduar me këto organizata, sipas nevojave dhe mundësive tona.

